

Njoftim për përqendrim me të cilin FLJUS SHPK BEOGRAD d.o.o. Beograd, Serbi, fiton kontrollin mbi shoqërinë BEN AIR SHPK, BEOGRAD (SAVSKI VENEC) Serbi,

(lënda nr. 08-156/2024)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24), më datë 29.11.2024, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka marrë njoftim për përqendrim me të cilin FLJUS SHPK BEOGRAD d.o.o. Beograd, me seli në adresën Tadije Sondermajera nr.5, 17, numër apartamenti 152, synon të fitojë kontroll të pavarur mbi shoqërinë BEN AIR SHPK, BEOGRAD (SAVSKI VENEC), Andre Nikoliq nr.3.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

FLJUS SHPK BEOGRAD d.o.o. është themeluar më 6 mars 2024 në Republikën e Serbisë për të kryer transport ajror të pasagjerëve. Kompania aktualisht është ende në fazën e përgatitjes për kryerjen e aktiviteteve, kështu që nuk ofron asnjë shërbim për palët e treta, as nuk gjeneron të ardhura.

FLJUS SHPK BEOGRAD d.o.o. njëkohësisht i përket grupit DELTA HOLDING, i cili është aktiv në Serbi dhe rajon në një numër të madh fushash të ndryshme të biznesit, dhe grupit EL&MI, i cili gjithashtu është aktiv në disa fusha të ndryshme të biznesit, duke pasur parasysh se pronarët e 50% të pjesëve në Blerësin janë AIRSTAR SHPK BEOGRAD (NOVI BEOGRAD), e cila është pjesë e grupit DELTA HOLDING dhe kompania EL&MI GROUP D.O.O. BEOGRAD.

FLJUS SHPK BEOGRAD d.o.o. Beograd nuk ka shoqëri të varura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

DELTA HOLDING GROUP, Kompanitë e grupit "Delta Holding" kryejnë aktivitetet e tyre në fushën e prodhimit bujqësor, prodhimit të ushqimit, eksportit, importit dhe përfaqësimit të kompanive të huaja, shpërndarjes së mallrave të konsumit të gjerë, shitjes së automjeteve, zhvillimit të pasurive të paluajtshme dhe zhvillimit të teknologjive të reja.

Delta Holding Group realizon aktivitetet e saj të biznesit përmes pesë njësive organizative: Delta Agrar Group, Delta përpunimi i ushqimit, Delta grupi i pasurive të paluajtshme, Delta shpërndarja dhe departamenti për teknologji të reja.

Përveç tregut serb, Delta Holding Group është e pranishme edhe në një numër të madh tregjesh në rajon dhe në Bashkimin Evropian.

Delta Holding Group ka shoqëri të varura në Republikën e Maqedonisë së Veriut me emrin:

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ANANAS MK SHPK Shkup, me seli në rr. Stoltenbergova nr.4/la.V/DP1, Qendër, Shkup, dhe

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ANANAS SHOP SHPKNJP Shkup me seli në rr. Stoltenbergova nr.4/la.V/DP1, Qendër, Shkup.

EL&MI GROUP D.O.O. BEOGRAD është themeluar më 24 maj 2012 në Republikën e Serbisë. Aktiviteti kryesor është prodhimi i energjisë elektrike (kodi i aktivitetit: 35.11).

Ka pozicionin e kompanisë mëmë në një grup kompanish me pronësi të kompanisë holding në kuptimin praktik. Brenda grupit ka disa kompani që merren me aktivitete të ndryshme ekonomike.

EL&MI GROUP D.O.O. BEOGRAD aktualisht nuk operon në tregun serb, duke pasur parasysh se kompania SOFT VAJT SHPK BEOGRAD, nga grupi EL&MI, ka pushuar së kryeri aktivitetin e transportit të pasagjerëve në trafikun ajror, dhe në vitin 2024 nuk ka pasur asnjë aktivitet biznesi.

EL&MI GROUP D.O.O. BEOGRAD nuk ka shoqëri të varura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

BEN AIR SHPK, BEOGRAD shoqëria e synuar është themeluar më 24 mars 2009 në Republikën e Serbisë.

Shoqëria e synuar nuk ka shoqëri të varura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni ka përcaktuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim tek Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën. Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

10.12.2024

Shkup